

Nr. 2503/023K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 27/03/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Komisionit Rregullator

Lënda: REKOMANDIME – Lidhur me Projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020, të komisionit rregullator “për miratimin e rregullave të veprimtarisë së policisë së shtetit në shërbim të zgjedhjeve”.

I Nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator!

Të ndëruar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Në kuadër të gjithë bashkëpunimit të deritanishëm me Institucionin e KQZ-së, **bashkëpunim për të cilin shprehet sërish falenderim**, bazuar në problematikat e vërejtura në proceset pararendëse zgjedhore si dhe në përvojën e ekspertizën e tij, KRIIK ju paraqet nevojën për marrjen në konsideratë prej Jush të gjithë sa më poshtë vijon lidhur me Projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020, të komisionit rregullator “për miratimin e rregullave të veprimtarisë së policisë së shtetit në shërbim të zgjedhjeve”:

Në pikën 3.6 të Vendimit nr. 24 të KRR, datë 21.03.2025 “Projekt vendim për disa shtesa në vendim nr. 11, datë 25.03.2021, “për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, i ndryshuar” citohet se:

“3. Në nenin 37, pas pikës 5, shtohen pikat 6, 7 dhe 8, me këtë përmbajtje:

“6. Koordinatorët e sigurisë individualisht kanë për detyrë të monitorojnë situatën vetëm në ambientet e jashtme të qendrave të votimit përfshirë hyrjet, oborret dhe perimetrin deri në 150 metra nga QV-ja, me qëllim evidentimi e grumbullimeve të paautorizuara ose të personave që monitorojnë zgjedhësit. Koordinatorët mbajnë kontakte të vazhdueshme me KZAZ-në, KQZ-në, si dhe të raportojnë çdo parregullsi, prani të personave të paautorizuar ose intimidim të zgjedhësve pranë Policisë së Shtetit për ndërhyrje të menjëhershme, sipas udhëzimeve të Komisionerit.”

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Sjellim në vëmendjen tuaj se ky formulim është i marrë nga versioni i projekt-aktit të dërguar me email KRIIK-ut nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me postë elektronike në datën 20 mars 2025. Vendimi final i miratuar nga KRR në datë 21 mars në faqen e KQZ-së nuk është i aksesueshëm pasi nuk mund të lexohet, ndërkohë që dokumenti i shkarkuar është në një format që nuk është i lexueshëm.

Ndërkohë, në pikën 6 të Projektvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020, të komisionit rregullator “Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së policisë së shtetit në shërbim të zgjedhjeve”, citohet:

“6. Në nenin 14, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në perimetrin prej 150 metrash rreth qendrës së votimit ndalohen sjelljet agresive, frikësuese, shantazhuese ose kërcënuese të çdo lloji forme, çdo veprim që pengon apo ndërhyr në hyrjen, daljen ose aksesin e zgjedhësve në ambientet e votimit, si dhe vendosja e materialeve që synojnë të ndikojnë tek votuesit.”

b) Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Në rastet kur koordinatorët e sigurisë konstatojnë praninë e personave të paautorizuar ose veprime që cenojnë mbarëvajtjen e procesit të votimit në ambientet e brendshme ose të jashtme të perimetrit të godinës ku ndodhen qendrat e votimit, ata sinjalizojnë menjëherë Policinë e Shtetit, si dhe informojnë KZAZ-në dhe KQV-në për situatën e krijuar. Policia është e detyruar të ndërhyjë pa vonesë për largimin e individëve që shkelin rregullat dhe të sigurojë që hapësira përreth vendndodhjes së qendrës së votimit të jetë e sigurt.”

Vërejmë se në Projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020, të komisionit rregullator “për miratimin e rregullave të veprimtarisë së policisë së shtetit në shërbim të zgjedhjeve” **mungojnë elementët e ndalimit të monitorimit të zgjedhësve dhe detyrimin eksplicit të Policisë së Shtetit për të ndërhyrë dhe larguar këta persona.**

Përfshirja eksplicite e ndalimit të monitorimit të zgjedhësve nga persona të paautorizuar në perimetrin prej 150 metrash rreth qendrës së votimit synon të mbrojtë votuesit nga çdo formë presioni, intimidimi apo ndikimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Gjithashtu, detyrimi i Policisë së Shtetit për të ndërhyrë pa vonesë në rastet e identifikimit të individëve që monitorojnë zgjedhësit siguron zbatimin efektiv të këtij rregulli dhe parandalon çdo ndërhyrje të paligjshme në procesin zgjedhor. Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar integritetin e votës dhe për të krijuar një mjedis të sigurt e të paanshëm për të gjithë zgjedhësit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Bazuar në sa më sipër, për të harmonizuar dy aktet dhe rritur efektivitetin e masave të ndërmarra, **KRIIK rekomandon që të përfshihen në Pikën 6 të Projektvendimit ndalimi i monitorimit të zgjedhësve dhe detyrimi eksplicit i Policisë së Shtetit për të ndërhyrë dhe larguar këta persona.**

Një formulim alternativ mund të ishte si më poshtë:

“6. Në nenin 14, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

*“2/1. Në perimetrin prej 150 metrash rreth qendrës së votimit ndalohen sjelljet agresive, frikësuese, shantazhuese ose kërcënuese të çdo lloj forme, çdo veprim që pengon apo ndërhyr në hyrjen, daljen ose aksesin e zgjedhësve në ambientet e votimit, vendosja e materialeve që synojnë të ndikojnë tek votuesit, **si dhe çdo formë monitorimi e zgjedhësve nga persona të paautorizuar.**”*

b) Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

*“4/1. Në rastet kur koordinatorët e sigurisë konstatojnë praninë e personave të paautorizuar, veprime që cenojnë mbarëvajtjen e procesit të votimit, **ose persona që monitorojnë zgjedhësit** në ambientet e brendshme ose të jashtme të perimetrit të godinës ku ndodhen qendrat e votimit, ata sinjalizojnë menjëherë Policinë e Shtetit, si dhe informojnë KZAZ-në dhe KQV-në për situatën e krijuar. Policia është e detyruar të ndërhyjë pa vonesë për largimin e individëve që shkelin rregullat, përfshirë personat që monitorojnë zgjedhësit, dhe të sigurojë që hapësira përreth vendndodhjes së qendrës së votimit të jetë e sigurt **dhe që zgjedhësit të mund të votojnë pa u ndikuar.**”*

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto GOGO

Kryetar

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania